



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË



NOTER HELENA B. SHENGJERGJI
ADRESA NR.10, BLV"GJERGJ
FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3
TEL: 682080755

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

Nr. repertori: 224

Nr. koleksioni: 83

Tirane më 09/03/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2020052860004384237

KONTRATE PER SHITBLERJEN E KUOTAVE TE KAPITALIT

Sot, më datë 09/03/2020, para meje Noter **HELENA B. SHENGJERGJI, (VAKO)**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.10, BLVD. "GJERGJ FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3, u paraqit personalisht:

• **Z. Albano Qojle**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i datelindjes 21.09.1972, lindur ne Berat dhe banues ne adresen Komuna Farke, Tirane, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 035701303, me Nr.personal H20921093V.

• **Z. Elton Ropi**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i datelindjes 11.05.1978, lindur ne Korce, dhe banues ne adresen Rr. Jordan Misja, Tirane, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 031800911 , me Nr. personal H80511170C.

(me poshte do te referohen si "Shitesit")

Dhe

• **Shoqeria Investment SHERKO - ikub GROUP Sh.p.k.**, shoqeri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar prane Regjistrat Tregtar me date 18.01.2012, me status Aktiv, e pajisur me NUIS: L21318042U, e perfaqesuar nga Ortaku i Vetem, Z. Romeo Sherko;

• **Shoqeria TAG Engineering Sh.p.k.**, shoqeri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar prane Regjistrat Tregtar me date 07.12.2017, me status Aktiv, e pajisur me NUIS: L72407008S, e perfaqesuar nga Administrastori i Pergjithshem Z. Armand Shara;

(me poshte do te referohen si "Bleresit")

Se bashku do te referohen si "Palet"

MEQENESE:

A. Shoqeria ikubINFO sh.p.k. (ketu e me poshte referuar si "Shoqeria") eshte themeluar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, dhe regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne date 12.05.2011, me NUIS L11712002T, me seli ne adresen Rruga "Abdyl Frasheri", EGT Tower, Pallati 11/1, Kati 2-3, Tirane, me kapital themeltar te regjistruar dhe teresisht te paguar prej 4,200,000 (kater milion e dyqind mije) Leke, i ndare ne 4 (kater) kuota.

B. Shitesit jane ortake te Shoqerise, ne te cilen:

Albano Qojle *RS*

[Signature] *[Signature]*

- Z. Albano Qojle është zoterues i një kuote me vlerë nominale 651,000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë) Leke, që përfaqëson 15.5% të kapitalit të Shoqërisë;
- Z. Elton Ropi është zoterues i një kuote me vlerë nominale 630,000 (gjashtëqind e tridhjetë mijë) Leke, që përfaqëson 15% të kapitalit të Shoqërisë;

C. Blerësit janë gjithashtu ortakë në Shoqërinë ikubINFO sh.p.k., nga të cilat:

- Shoqëria Investment SHERKO – ikub GROUP Sh.p.k. është zotuese e një kuote me vlerë nominale 1,743,000 (një milion e shtatëqind e dyzetë e tre mijë) Leke, që përfaqëson 41.5% të kapitalit të Shoqërisë;
- Shoqëria TAG Engineering Sh.p.k. është zotuese e një kuote me vlerë nominale 1,176,000 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) Leke, që përfaqëson 28% të kapitalit të Shoqërisë;

D. Shitesit, bien dakord të transferojnë pronesinë e kuotës që zoterojnë në kapitalin e shoqërisë ikubINFO sh.p.k. tek Blerësit, nëpërmjet shitjes së saj në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

ATEHERE:

Palet bien dakord për nënshkrimin e kësaj Kontrate për shitblerjen e kuotës të kapitalit, kështu që me poshtë referuar si “Kontrata”, me kushtet dhe përmbajtjen si me poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontrates

1.1 Objekt i kësaj kontrate është transferimi i pronesisë së kuotës të zotuar nga Shitesit, nëpërmjet shitjes tek Blerësit, si me poshtë:

- Shitesi Z. Albano Qojle i shet Blerësit Investment SHERKO – ikub GROUP Sh.p.k. 59.71% të kuotës së tij, që përben 9.26% të Kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 388,727 (treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzetë e shtatë) Leke.
- Shitesi Z. Albano Qojle i shet Blerësit TAG Engineering Sh.p.k. 40.29% të kuotës së tij, që përben 6.24% të Kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 262,273 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) Leke.
- Shitesi Z. Elton Ropi i shet Blerësit Investment SHERKO – ikub GROUP Sh.p.k. 59.71% të kuotës së tij, që përben 8.96% të Kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 376,187 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) Leke.
- Shitesi Z. Elton Ropi i shet Blerësit TAG Engineering Sh.p.k. 40.29% të kuotës së tij, që përben 6.04% të Kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 253,813 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e trembëdhjetë) Leke.

Neni 2

Cmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës

2.1 Cmimi i Kuotave në Shitje që do të paguhet nga Blerësit është:

Blerësi Shoqëria Investment SHERKO – ikub GROUP Sh.p.k. do t'i paguaje

Albano Qojle

RS

[Signature]

[Signature]

- Shitesit Z. Albano Qojle, sipas kushteve dhe afateve ne kete kontrate, cmimin prej 388,727 (treqind e tetedhjetë e tete mije e shtateqind e njezete e shtate) Leke.
- Shitesit Z. Elton Ropi sipas kushteve dhe afateve ne kete kontrate, cmimin prej 376,187 (treqind e shtatedhjetë e gjashte mije e njeqind e tetedhjetë e shtate) Leke.

Bleresi Shoqeria TAG Engineering Sh.p.k. do t'i paguaje:

- Shitesit Z. Albano Qojle, sipas kushteve dhe afateve ne kete kontrate, cmimin prej 262,273 (dyqind e gjashtedhjetë e dy mije e dyqind e shtatedhjetë e tre) Leke.
- Shitesit Z. Elton Ropi sipas kushteve dhe afateve ne kete kontrate, cmimin prej 253,813 (dyqind e pesedhjetë e tre mije e teteqind e trembedhjetë) Leke.

2.2 Pagesa e Cmimit te shitjes, sipas pikes 2.1 me siper te ketij neni, do te paguhet nga Bleresit tek Shitesi nepermjet transfertes bankare ne Llogarine bankare respektive ne emer te Shitesit, brenda 5 (pese) ditesh nga data e nenshkrimit te Kontrates. Shuma e Cmimit të Shitjes do të jetë shuma maksimale totale e cmimit që Blerësi do të paguajë për blerjen Kuotës së Shoqërisë dhe Shitësi garanton se Blerësi nuk do të paguajë shuma të tjera përveç Cmimit të Shitjes.

2.3 Ne rast se Cmimi i Blerjes nuk paguhet ne llogarine e Shitesit sipas parashikimeve te nenit 2.2, Shitesi ka te drejte t'i kerkoje secilit prej Bleresve kryerjen e pageses brenda afatit te paracaktuar prej tyre. Ne rast se Bleresit nuk kryejne pagimin e vleres edhe pas ketij afati atehere zgjidhja e mosmarreveshjes do te trajtohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 3

Transferimi i Pronesise

3.1 Pronesia mbi kuotat sipas kesaj Kontrate transferohet nga Shitesit tek Bleresit ne momentin e nenshkrimit te Kontrates.

3.2 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesit zhvishen nga te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga pronesia mbi kuotat e transferuara dhe keto te drejta e detyrime kalojne tek Bleresit, ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate, legjislacionin ne fuqi dhe Statutin e Shoqerise. Pavaresisht dates se nenshkrimit te kesaj kontrate, Shitesit pranojne qe nuk kane te drejten e dividendit per fitimet e realizuara gjate vitit 2020.

3.3 Blerësit do të ndjekin procedurën pranë QKB-së për regjistrimin e kësaj Kontrate. Për këtë qëllim Shitesit do te sigurojne qe kjo Kontrate te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit brenda 30 ditesh kalendarike nga data e Kontrates.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci

4.1 Shitesit deklarojne dhe garantojne ndaj Bleresve dhe ne favor te tyre se secila nga garancite dhe deklarimet ("Garancite e Shitesit") ne vijim jane te verteta dhe te sakta si ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate ashtu dhe ne daten e kalimit te pronesise mbi Kuotat ne Shitje.

4.2 Shitesit gezojne te gjitha te drejtat dhe aftesine ligjore per te lidhur kete Kontrate dhe per te perfunduar transaksionet, per te cilat eshte rene dakord ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.

Albano Qojle *RS*

[Signature] *[Signature]*

4.3 Kuotat jane te lira e te shkarkuara nga cdo Barre e cfare doloj forme qofte dhe Shitesit kane te drejte dhe zotesi te plote per te shitur dhe transferuar pronesine mbi to ne perputhje me kete Kontrate.

-Nuk ka asnje marreveshje qofte gojore apo me shkrim per te krijuar apo vendosur ndonje Barre mbi Kuotat apo pjese te tyre dhe nuk eshte marre asnje vendim per rritjen e kapitalit te Shoqerise.

-Kuotat jane te shkarkuara nga cdo e drejte apo pretendim i te treteve. Me perjashtim te kesaj Kontrate, nuk ekziston asnje kontrate, marreveshje, veprim juridik me shkrim apo me goje, me kusht ose jo me te trete, objekt i se ciles eshte krijimi, kalimi, shitja, blerja, parablerja, vendosja e ndonje Barre apo opsioni per te blere apo shitur Kuotat ne Shoqeri apo per te konvertuar borxhin e te treteve ne kuota ne Shoqeri.

4.4 Shitesit detyrohen te demshperblejne Bleresit apo / dhe Shoqerine, ne cdo kohe si pasoje e:

a) ngjarjeve, rrethanave apo fakteve te cilat kane lindur, ndodhur apo vertetuar perpara nenshkrimt te kontrates kryesore te shitjes; ose

b) ngjarjeve, rrethanave apo fakteve qe kane lidhje me veprime apo mosveprime te Shitesve, perpara nenshkrimt te kontrates te shitjes.

4.5 Ne rast se per kuotat ne shitje ne cdo kohe lindin cenime te cfaredo lloji nga pale te treta qe bejne te mundur cenimin e te drejtes se pronesise te Bleresve, per efekte te pavlefshmerise se veprimeve per shitjen e kuotes/kuotave, Shitesit angazhohen te zgjidhin cdo problem. Nese problemet nuk zgjidhen dhe Bleresve ne kete kontrate u cenohen te drejtat e pronesise mbi kuoten / kuotat, atehere Shitesit angazhohen te demshperblejne Bleresit per cdo cenim apo dem te shkaktuar. Ne cdo rast, Shitesit kane detyrim qe deri ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve me palet e treta, mosmarreveshje qe burojne ne lidhje me kuotat dhe te drejtat / detyrimet mbi to, te perballoje vete te gjitha shpenzimet noteriale, avokatie, gjyqesore, por jo vetem, duke i mbajtur te pademtuar Bleresit.

Neni 5

Gjendja perfundimtare e kuotave te Shoqerise

5.1 Pas transferimit te pronesise, sipas kesaj Kontrate, gjendja e pjesemarrjes se ortakeve ne kapitalin e Shoqerise ikubINFO sh.p.k. do te jete:

- Shoqeria Investment SHERKO – ikub GROUP Sh.p.k. eshte zoteruese e nje kuote me vlere 2,507,914 (dy milion e peseqind e shtate mije e nenteqind e katermbdhjete) Leke, qe perfaqesojne 59.71% te kapitalit te Shoqerise;
- Shoqeria TAG Engineering Sh.p.k. eshte zoteruese e nje kuote me vlere nominale 1,692,086 (njemilion e gjashteqind e nentehjete e dy mije e tetehjete e gjashte) Leke, qe perfaqesojne 40.29% te kapitalit te Shoqerise;

Neni 6

Deklarimet dhe garancite e Bleresve

6.1 Bleresit paraqesin dhe garantojne ndaj Shitesve dhe ne favor te tyre, se secila nga garancite dhe deklarimet ne vijim jane te verteta dhe te sakta ne daten e nenshkrimt te kesaj kontrate.

6.2 Bleresit jane persona juridike te organizuar dhe qe operojne sipas ligjeve shqiptare.

Albano Dajle

RS





6.3 Bleresit gezojnë te gjitha te drejtat, autoritetin dhe aftësitë ligjore për të lidhur këto Kontrata dhe për të perfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

6.4 Bleresit nuk janë në gjendje falimentimi ose subjekt i ndonjë procedure likuidimi në çfarëdo juridiksioni dhe nuk kanë propozuar asnjë marrëveshje apo ujdë me çfarëdo klase kreditorësh.

Neni 7

Demshperblimi

7.1 Në rast se Bleresit perkatesisht nuk permbushin detyrimet e tyre në këto Kontrata dhe/ose shkelin deklarimet dhe garancite e dhëna në Nenin 6, atëherë Shitesit kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar permbushjen e detyrimit dhe çdo humbje apo demshperblim tjetër si pasojë e mospermbushjeve apo shkeljeve të Bleresve.

7.2 Në rast se Shitesi nuk permbush detyrimet e tij në këto Kontrata dhe/ose shkel deklarimet dhe garancite e dhëna në Nenin 4, atëherë Bleresit kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar permbushjen e detyrimit dhe çdo humbje apo demshperblim tjetër si pasojë e mospermbushjeve apo shkeljeve të Shitesit.

Neni 8

Kostot

8.1 Secila Pale merr persiper kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjrisht ose sipas kontratave për shitjen e Kuotave në Shitje.

8.2 Çmimi i Shitjes nuk do të përfshijë tarifën, taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër të nevojshëm për kalimin e pronësisë mbi Kuotën, të cilat do të paguheshin plotësisht nga Blerësi, me përjashtim të tatimit mbi të ardhurat që janë në ngarkim dhe do të paguheshin nga Shitesi, që në rastin konkret do të mbaheshin në burim dhe paguheshin për llogari të Shitesit nga Bleresi. Ky i fundit në këto rast do të pajiset me vërtetim për pagimin e taksave/tatimeve Bleresin.

Neni 9

Informacione konfidenciale dhe ndalimi i perhapjes dhe përdorimit të tij

9.1 Termi "Informacion Konfidencial" do të thotë të gjitha informacionet e një natyre konfidenciale, pronësore ose sekrete të shpalosura për Shitesit ose të marra ndryshe nga Shitesit në lidhje me shoqërinë ikubINFO shpk dhe këto Kontrata, dhe që kanë të bëjnë, por jo vetëm, me organizatën, punonjësit, kushtet financiare ose planet e biznesit të shoqërisë, klientëve, procedurave, planeve, përvijës operative, filialeve ose bashkëpunëtorëve të saj, etj.

9.2 Në masën që, Shitesit disponojnë informacionin në lidhje me Bleresin dhe me Shoqërinë ikubINFO shpk që është caktuar nga Bleresi si konfidencial ose është nga natyra e tij qartësisht konfidencial (ketu e tutje "Informacioni Konfidencial"), Shitesit marrin persiper të ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe të mos zbulojnë informacionin konfidencial ndaj paleve të treta pa pelqimin e Bleresit apo/dhe të mos përdorin, në asnjë lloj mënyre apo/dhe mjeti, vetë ose nepermjet të tretëve, informacionin konfidencial pa pelqimin e Bleresit.

9.3 Në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe në ligjet e detyrueshme ose standardet profesionale, detyrimi i konfidencialitetit të përmendur në këto nen nuk do të zbatohet për informacionin që;

Ilbano dyje

RS

Elgi

RS

☐ Eshte apo ne te kundert do te behej i disponueshem publikisht (duke perfshire, pa kufizim, çdo informacion te dorezuar ne çdo agjenci qeveritare dhe te disponueshem per publikun), perveçse kur eshte si rezultat i shkeljes se detyrimit te konfidencialitetit nga Shitesit; ose

☐ Behet i disponueshem per Shitesit nga nje pale e trete pa patur ne thelb te njejtat kufizime te specifikuara ketu;

9.4 Bleresit njohin dhe pranojne qe Shitesit kane te drejte te bejne publik Informacionin Konfidencial kur kjo kerkohet nga ligji apo ne perputhje me ligjin ne fuqi, nga gjykata, autoritet qeveritare, rregullatore apo autoritete te tjera perkatese. Dhenia e ketij informacioni nuk do te konsiderohet si shkelje e detyrimeve te konfidencialitetit nga ana e Shitesit. Vetem nese ndalohej nga legjislacioni ne fuqi, Shitesit kur zbulojne informacionin duhet te beje çdo perpjekje te arsyeshme per te njoftuar Bleresit paraprakisht per nje zbulim te tille dhe duhet t'i ofroje Bleresit, asistencen e duhur qe mund te kerkohet ne menyre te arsyeshme, qe Bleresi te mund te nderhyje dhe ndaloje zbulimin e informacionit, nese eshte e pershtatshme.

9.5 Ne rast te mosnjoftimit paraprak, Shitesit kur zbulojne informacionin, do te informojne Bleresit rreth zbulimit te informacionit menjehere pas zbulimit te tij, perveçse kur ndalohej nga ligji ne fuqi.

9.6 Gjate kohezgjatjes se kontrates dhe per nje periudhe te pakufizuar pas kesaj, Shitesit do te mbajne sekret te gjithe informacionin konfidencial, nuk do ta perdorin ate vete apo/dhe nepermjet te treteve dhe do te zbatojne procedura te tilla te sigurise qe mund te jene te nevojshme per te ruajtur sekretin e informacionit konfidencial.

Neni 10

Kushti penal

10.1 Pavaresisht parashikimeve te nenit 7, ne rast te mospermbushjes se detyrimit te percaktuar ne nenin 9 nga ana e Shitesve, bazuar ne parashikimet e nenit 541 e vijues te Kodit Civil, si mjet per garantimin e permbushjes se detyrimeve te marra persiper ne nenin 9 nga ana e Shitesit, vendoset Kushti penal ne formen e pageses se nje shume te hollash sic percaktohet ne piken 10.2.

10.2 Ne rast te mospermbushjes se detyrimit te percaktuar ne nenin 9 nga ana e Shitesve, keta te fundit detyrohen t'u paguajne Bleresve shumen prej 5 Milione Leke. Kjo shume do te ndahet: shoqeria Investment SHERKO – ikub Group Sh.p.k 59.71% dhe shoqeria TAG Engineering Sh.p.k 40.29%. Afati i ketij detyrimi eshte deri ne 31 Dhjetor 2021.

Neni 11

Ligji i zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreveshjeve

11.1 Kjo Kontrate, perfshire anekset e saj dhe te gjitha faktet e lidhura, do te qeveriset dhe interpretohet ne perputhje me ligjin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise. Cdo veprim juridik ose procedure qe lind nen ose ne lidhje me Kontraten ose sherbimet do t'i referohet dhe mbahet para gjykatave kompetente te Republikes se Shqiperise.

11.2 Palet Kontraktuese bien dakord te perdorin perpjekjet e tyre per te zgjidhur me negociata, me mirebesim dhe pa vonese te panevojshme, çdo mosmarreveshje ose pretendim qe lind nen ose ne lidhje me kete Kontrate. Nese nje mosmarreveshje ose kerkese nuk zgjidhet brenda 30 diteve nga paraqitja e nje

Ilbano Dajli

RS

[Signature]

mosmarreveshje / pretendimi te tille Pales tjeter Kontraktuese per negocim, secila Pale Kontraktuese do te autorizohet te paraqese mosmarreveshjen para Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane per zgjidhje. Asgje e specifikuar ne kete paragraf nuk do te ndaloje asnje nga Palet Kontraktuese te filloje procedurat gjyqesore ne lidhje me mbrojtjen e te drejtave te pronesise intelektuale, sekretet e biznesit, ose informacionin konfidencial ose ruajtjen e ndonje te drejte ligjore ose mjete juridike ne dispozicion ne çdo kohe para ose pas fillimit te zgjidhjes se mosmarreveshjeve pajtuese.

Neni 12

Titujt

12.1 Titujt dhe titujt e seksioneve ne kete Kontrate kane per qellim vetem lehtesine e references dhe nuk synojne dhe nuk do te interpretohen per te shpjeguar, modifikuar ose vendosur ndonje rregullim ne cilindo dispozite te kesaj Kontrate. Interpretimi i kesaj Kontrate behet bazuar ne qelimin e tij dhe jo vetem ne kuptimin e mirefillte te fjaleve.

Neni 13

Pajtueshmëria me ligjet

13.1 Palet do te respektojne te gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret ne fuqi ne lidhje me performancen e tyre ne baze te kesaj Kontrate.

Neni 14

Marreveshja e plote dhe ndryshimet

14.1 Kontrata perfaqeson te gjithe marreveshjen e Paleve Kontraktuese per çeshtjen ne fjale dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme, detyrimet, perfaqesimet ose komunikimin e Paleve Kontraktuese, verbale ose te shkruara, ne lidhje me objektin e Kontrates, perveç nese kjo Kontrate parashikon ndryshe.

14.2 Nese ndonje autoritet kompetent percakton qe ndonje nga dispozitat e parashikuara ketu eshte e pavlefshme, jo efektive ose e pazbatueshme, kjo dispozite do te konsiderohet e perjashtuar nga kjo Kontrate. Dispozitat e tjera do te mbeten plotesisht te vlefshme dhe efektive, me kusht qe ato nuk rrjedhin nga dispozita apo permbajtja e saj ose rrethanat nder te cilat dispozita ishte vendosur, ne menyre qe dispozita te mos ndahet nga dispozitat e mbetura ne kete Kontrate. Ne kete rast, Palet Kontraktuese do te kryejne ndryshime, ne menyre qe te arrijne te njejtin efekt ose, nese nuk eshte e mundur, efektin me te afert te mundshem si dispozita e pavlefshme, jo efektive apo qe eshte e pazbatueshme.

14.3 Perveç nese kjo kontrate percakton ne menyre te qarte ndryshe, asnje ndryshim nuk do te hyje ne fuqi perveç nese miratohet nga te dyja Palet Kontraktuese ne forme te shkruar dhe nenshkruar nga perfaqesuesit e autorizuar te te dy Paleve Kontraktuese.

14.4 Perveç kur parashikohet ndryshe ne Kontrate, çdo njoftim qe i jepet nga secila Pale Kontraktuese, Pales tjeter Kontraktuese do te jete me shkrim dhe ne gjuhen shqipe ose anglisht. Njoftimet do te dorezohen me dore ose do te dergohen me poste te regjistruar, ose me poste elektronike ne adresen e selise, ose adresen e postes elektronike te Pales tjeter Kontraktuese, dhe konsiderohet se jane marre:

- Ne rastin e dorezimit me dore, kur dorezohet;
- Ne rastin e postes elektronike, pas pranimit nga marresi.

Zj. Suela Qojle, ne cilesine e bashkeshortes se z. Albano Qojle eshte ne dijeni te ketij transaksioni dhe nepermjet prokures nr.184Rep, nr.60 Kol, date 24.02.2020 ka dhene pelqimin e saj per shitjen e kuotes se Z. Albano Qojle dhe autorizon kete te fundit te nenshkruaj ne emer dhe per llogari te saj. Prokura i bashkengjitet kesaj kontrate.

Unë noteri deklaroj se mora autorizimin për përdorimin e të dhënave personale të palëve dhe se të dhënat e përdorura nga unë në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti dhe rregjistrimit të tij në RNSH.

Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" Nr. 9887, datë 10/03/2008, i ndryshuar".

Kontrata u redaktua ne 7 (SHTATE) kopje origjinale me vlere te njejte midis tyre me nga 3 (tre) faqe te lidhura me vulë të njomë midis tyre. Kontrata ju Ju lexua palëve me zë të lartë dhe të qartë nga unë noteri, të cilët deklaruan se e kuptuan atë, dhe meqënëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë rregullisht para meje. Unë noteri e vërtetoj ate sipas ligjit.

SHITESIT :

Albano QOJLE

Albano Qojle

Elton ROPI

Elton Ropi

Dhenese Pelqimi
Suela Qojle

Albano Qojle

BLERESIT :

Investment SHERKO-ikub GROUP Sh.p.k.
Romeo SHERKO

Romeo Sherko

TAG Engineering Sh.p.k.
Armand SHARA
Administrator i Pergjithshem

Armand Shara



Noter

HELENA SHENGJERGJI (VAKO)

Helena Shengjergji, vaka

[Signature]

VENDIM Nr. 3

I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE

Investment Sherko – ikub GROUP shpk



Selia: Rr. Ismail Qemali, Pll. 27, shk. 1, nr. 30 Tirane

NIPT: L21318042U

Sot, me date 03/03/2020, ne mbledhjen e radhes te Asamblese se Pergjithshme, ne Seline e Shoqerise Rr. Rruga Ismail Qemali, Pallati 27, Shk.1, Nr.30, Tirane, une, Romeo SHERKO, Ortaku i vetem posedues i 100% te kapitalit te shoqerise, ne perputhje me parashikimet ligjore neni 81 e vijues per vendimarrje te vlefshme, ne rolin e Asamblese se Pergjithshme do te marre vendim per pikat e meposhtme;

1. Blerjen ne masen 59,71% te kuotes se Z. Albano Qojle ne shoqerine ikubINFO shpk dhe te 59,71% te kuotes se z. Elton Ropi ne shoqerine ikubINFO shpk

Ortaku i vetem Vendosi,

VENDIM

1. Miratohet blerja ne masen 59,71% te kuotes se Z. Albano Qojle ne shoqerine ikubINFO shpk dhe te 59,71% te kuotes se z. Elton Ropi ne shoqerine ikubINFO shpk. Vlera e blerjes do te jete sipas vleres nominale te kuotes.
2. Ortaku i vetem, z. Romeo Sherko do te jete perfaqesuesi i Shoqerise per nenshkrimin e kontrates se Transferimit te Kuotave, te nenshkrimit te Marreveshjes se Barres Siguruese, dhe tek mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise ikubINFO Shpk., per miratimin e Shitjes-Blerjes se kuotave sipercituar.

Ortaku i Vetem

Romeo SHERKO



SHOQERIA TREGTARE
TAG Engineering sh.p.k.
NUIS L72407008S
Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tirane.



V E N D I M
I ORTAKUT TE VETEM
TE SHOQERISE TREGTARE TAG ENGINEERING SH.P.K.
Nr. 14 Dt. 03/03/2020

Sot, me date 03.03.2020, ne seline e shoqerise TAG Engineering sh.p.k., e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 07.12.2017, me NUIS L72407008S, me adrese ne: Rruga Murat Toptani, Gjergji Center, Tirane, u mbledh Asambleja e Ortakut te Vetem te shoqerise, i evidentuar si me poshte:

- **Z. Armand Shara**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, lindur dhe banues ne Tirane, identifikuar me pasaporten Nr. BC1787185 dhe Nr. personal H10709088K.

Ortaku i vetem i shoqerise mund te marre Vendime te vlefshme lidhur me ceshtjen e rendit te dites, si me poshte vijon:

1. Blerjen ne masen 40,29% te kuotes se Z. Albano Qojle ne shoqerine ikubINFO shpk dhe te 40,29% te kuotes se z. Elton Ropi ne shoqerine ikubINFO shpk.
2. Vendosja e barres siguruese ne favor te Z.Albano Qojle mbi pjesen e kuotes se blere.

Pas nje shqyrtimi te kujdesshem te ceshtjes se rendit te dites, Ortaku i Vetem i shoqerise,

VENDOSI:

1. Miratohet blerja ne masen 40,29% te kuotes se Z. Albano Qojle ne shoqerine ikubINFO shpk dhe te 40,29% te kuotes se z. Elton Ropi ne shoqerine ikubINFO shpk. Vlera e blerjes do te jete sipas vleres nominale te kuotes.
2. Miratohet vendosja e Barres Siguruese per blerjen e pjeses 40,29 % te kuotes qe zoteron z. Albano Qojle ne kapitalin e shoqerise ikubInfo shpk.
3. Kjo barre do te sherbeje si garanci per ekzekutimin e detyrimeve qe Shoqeria ikubINFO shpk ka ndaj Z. Albano Qojle sipas kushteve te rena dakord ndermjet palëve.
4. Ortaku i vetem, z. Armand Shara do te jete perfaqesuesi i Shoqerise Tag Engineering shpk per nenshkrimin e Kontrates se Shit -Blerjes te Kuotave, te nenshkrimit te


Marreveshjes se Barres Siguruese, dhe te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise ikubINFO Shpk. per miratimin e Shitjes-Blerjes se kuotave sipercituar dhe cdo akti ne zbatim te tij.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

TAG Engineering SH.P.K

Armand SHARA





REZULTATET E KËRKIMIT

INFORMACION I PËRGJITHSHËM :

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20200309105324522
Data e Rezultatit të Kërkimit: 09.03.2020
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 10:53:24AM
Lloji i Kërkimit: **Emri i Personit Juridik**
Kriteri i Kërkimit: (EM) IKUBINFO SH.P.K.

Numri i Dokumentit: D-400-629-368'
Referenca e Përdoruesit:

NUMRI I REZULTATEVE TE GJETURA SIPAS :
(EM) IKUBINFO SH.P.K.

ËSHTË 1



REGJISTRIMI - A-20200107094309143

Data e regjistrimit: 07.01.2020
Ora e regjistrimit: 9:43:09AM
Kohëzgjatja e Regjistrimit (vite): 24
Data e Përfundimit të Regjistrimit: 07.01.2044
Numri i Dokumentit: A-313-001-1130
Referenca e Përdoruesit:

BARRËMARRËSI (Kreditori):

Emri i Personit Fizik/Juridik
(EM) BANKA E TIRANES SH.A.

Adresa
Adresa: BLVD. ZOGU I, NR. 55/1 J61924008V
TIRANE-TIRANE
SHQIPERI
Tel: 247139
Fax: 233417
Email:

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERË
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

BARRËDHËNËSI (Debitori):

Emri i Personit Fizik/Juridik
(EM) INFOSOFT SYSTEMS
SH.P.K.

Adresa

Adresa: RR. MURAT TOPTANI, GJERGJI CENTER
J61820021C
TIRANE-TIRANE
SHQIPERË
Tel:
Fax:
Email:

(EM) IKUBINFO SH.P.K.

Adresa: RR. ABDYL FRASHERI, EGT TOWER,
PALL.11/1 L11712002T
TIRANE-TIRANE
SHQIPERË
Tel:
Fax:
Email:

MALLRA ME NUMER SERIE

Nr. i Serise

Prodhuesi

Viti

KOLATERAL PERSHKRIM:

BAZUAR NË MARRËVESHJEN SIGURUESE NR. 5876REP/NR. 2389KOL, DATË 24.12.2019 TË NOTERE EDLIRA MALAJ, BARRËDHËNËSI VENDOS BARRË SIGURUESE MBI:

(I) TË GJITHA TE ARDHURAT QE RRJEDHIN NGA KONTRATA E SHËRBIMIT (CONTRACT AGREEMENT) LIDHUR ME DATE 15.08.2019 NDËRMJET BARRËDHËNËSIT SHOQËRISË "INFOSOFT SYSTEMS" SH.P.K DHE SHOQËRISË "IKUBINFO" SH.P.K (NE CILESINE E "FURNIZUESIT") DHE «AGENCY FOR THE DELIVERY OF INTEGRATED SERVICES IN ALBANIA (ADISA)(AGJENSIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA)» (NE CILESINE E "PERFITUESIT"), ME OBJEKT: « SUPPLY AND INSTALLATION OF INTEGRATED FRONT OFFICE SERVICE DELIVERY PLATFORM REF :8521/G/ICB/1.06», ME VLERE KONTRATE NË SHUMËN PREJ EUR 1,545,600 (NJE MILION E PESEQIND E DYZETE E PESE MIJE E GJASHTEQIND EURO) PËRFSHIRË TVSH, DUKE PËRFSHIRE EDHE ÇDO AMENDIM TË KËSAJ KONTRATE NË TË ARDHMEN;

(II) CDO TE ARDHUR SHTESE, INTERESA DHE NE PERGJITHESI CDO KREDI QE RRJEDH NGA KETO KONTRATA TË PËRMENDURA NË PIKAT (I) MË SIPËR.

RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANë, SHQIPERË
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

PERSONI REGJISTRUES:

Emri i Personit Fizik/Juridik



Adresa

Tel:

Fax:

Email:

NËNSHKRIMI I AUTORIZUAR :

Emri dhe Mbiemri

GRELA KOCI

FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20200107094309143



Grelda Koci

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX.: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

Fundi i Rezultatit të Kërkimit:

Fundi i Dokumentit:



Chris Iloku



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20200309105324522
Data e Rezultatit të Kerkimit: 09.03.2020
Orë e Rezultatit të Kerkimit: 10:53:24AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-629-368'
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ELTON ARISTOKLI ROPË
ALBANO MITAT QOJLË



Charles Shoku